



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.434/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë

VE N D I M

- I. Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.434/2025 e datës 07.02.2025.
- II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1.000.00 (njëmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 07 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Istog, ka identifikuar në profilin në instagram, të kandidates për deputete nga lista e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Serbeze Kabashi Muçaj, një video me tekst shoqëruar, të realizuar në hapësirat e brendshme të Muzeut Komunal në Istog, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore, duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale. Më tej në ankesë pretendohet se Kandidatja për deputete, Serbeze Kabashi Muçaj, me qellim të përfitimit të votave shfrytëzon hapësira të institucioneve publike për të promovuar veten dhe subjektin politik LDK, ku me

këtë veprim janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 36 paragrafi i LZP-së. Si provë ka bashkangjitur fotografi dhe video në link: <https://ëëë.facebook.com/ëatch/?mibextid=ëëXlfr&v=1291664862046999&rdid=PYdRVpSyKrQeCkAë>.

Në përgjigjen në ankesë të datës 09.02.2025, theksohet, pretendimi se Subjekti Politik LDK dhe kandidatja, Serbeze Kabashi Muqaj, ka shkelur nenin 36 paragrafi I të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, konsiderojnë se ligjërisht nuk qëndron, sa i përket rastit të videos në Muzeun Komunal të Istogut, për të cilin ka leje apo pëlqim, sepse i njëjti është institucion kulturor dhe bazuar në nenin 4 paragrafi 2 të Rregullores zgjedhore 07/2024 një gjë e tillë lejohet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë, vëren se ankesa është bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i videos nuk është aktiv në llogarinë në instagram të kandidatës për deputete nga radhët e subjektit politik LDK, Serbeze Kabashi Muqaj, mirëpo paneli ka vërtetuar nga provat e ofruara nga pala ankuese se tubimi-video dhe foto është bërë në hapësirat e brendshme të Muzeut të Komunes së Istogut. Nga prova materiale të bashkangjitura në ankesës të Subjektit Politik LDK, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatës për deputete nga radhët e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, është shkelur Rregullorja Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidatja në fjalë, me qëllim të promovimit të numrit në listën me të cilën kandidon për deputete, ka bërë video, dhe foto në hapësirat e brendshme të Muzeut të Komunes së Istogut, për fushatë zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim edhe me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*. E në paragrafin 3 të kësaj dispozite përcaktohet se *“me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik”*.

Sipas përgjigjes së dhënë në ankesë theksohet se kandidatja për deputete, Serbeze Kabashi Muqaj, ka pasur pëlqim për vizitë dhe shfrytëzim të hapësirës të Muzeut të Komunes së Istogut, për të cilën e njëjta në përgjigje nuk ka bashkangjitur pëlqimin me të cilin Komuna e Istogut ti ketë lëshuar për tu vizituar në kohë të fushatës zgjedhore, vendi në fjalë, ku në bazë të nenit 4 paragrafi 2 të Nr.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, përcaktohet se subjektet politike të certifikuara mund të mbajnë tubime në hapësirat publike në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre, dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ. Çka do të thotë se fjala është për tubime ku duhen hapësirat për tu zhvilluar.

Kështu kandidatja në fjalë nga Subjekti Politik LDK, nuk ka pas të drejtë të kërkojë e as të ipet pëlqim për shfrytëzimin e objekteve të tilla. Sipas vlerësimit të panelit konkludohet se tubimi është bërë në hapësirat e brendshme të Muzeut Komunal, pasi që nga provat e ofruara shihen numri rendor i kandidates, Serbeze Kabashi Muqaj në listën e subjektit politik, LDK, dhe se kjo video gjatë fushatës zgjedhore është bërë me qëllim të përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidates për deputete, Serbeze Kabashi Muqaj, bie ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të LZP-së dhe rregullës zgjedhore 07/2024.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, si dhe përmirësimin e shkeljes në këtë rast heqjes së videos nga Rrjeti social facebook, kjo konsiston në atë se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet për afërsisht të ngjashme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.434/2025, datë 10.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.